

Numri i aktit	28.08.2024
Udhëzues	Smirno
Numri i aktit	03 2597 3
Vite	1



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

**Fakulteti i Filologjisë**

Lëndë/Pozitat:

1. Fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane, 2. Sintaksë e gjuhës gjermane, 3. Gjuhësi teksti, 4. Metodikë e gjuhës gjermane me observim, 5. Morfologji e gjuhës gjermane, 6. Shkrim akademik, 7. Leksikologji dhe fjalëformim, 8. Metodikë me praktikë shkollore

Komisioni vlerësues (prej 5 ose 3 anëtareve):

1. Kryetar Prof. Asoc. Dr. Blertë Ismajli
2. Anëtar Prof. Asoc. Dr. Sadije Rexhepi
3. Anëtar Prof. Asoc. Dr. Teuta Abrašiti

Kandidatët e paraqitur sipas pozitave/lëndëve të shpallura me thirrjen publike (numrat rendor shihen ose fshihen sipas nevojës dhe varësisht nga numri i pozitave apo kandidatëve):

Pozita/lëndët: III. 14. Fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane, Sintaksë e gjuhës gjermane, Gjuhësi teksti, Metodikë e gjuhës gjermane me observim, Morfologji e gjuhës gjermane, Shkrim akademik, Leksikologji dhe fjalëformim, Metodikë me praktikë shkollore

1. Dalina Berisha
2. Valona Asllani
3. Brisilda Kaçiu



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

*(Raporti përmbledhës duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/ëndë të përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatët që propozohen për angazhim si bashkëpunëtorë të jashtëm).*

Në Thirrjen publike me nr. prot. 2/426, dt. 25/07/2024, shpallur nga UP, për pikën III.14 (një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët: Fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane, Sintaksë e gjuhës gjermane, Gjuhësi teksti, Metodikë e gjuhës gjermane me observim, Morfologji e gjuhës gjermane, Shkrim akademik, Leksikologji dhe fjalëformim, Metodikë me praktikë shkollore) janë paraqitur tri candidate. Në vijim po e paraqesim raportin për secilin prej tyre.

- 1. MA Dalina Berisha (20.10.1997)** ka mbaruar studimet BA (8.85) dhe MA (9.45) në Departamentin e Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane të Fakultetit të Filologjisë (UP). Studimet MA i ka përfunduar me mbrojtjen e temës në fushën e gjuhësisë. Në shtator 2024 pritet t'i përfundojë edhe studimet MA në drejtimin e gjerministikës në Universitetin Heinrich Heine në Düsseldorf (nota mesatare 2,10 sipas sistemit gjerman të vlerësimit). Kandidatja ka dëshmi për përfundimin e disa trajnimeve dhe punëtorive në fushën e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj. Nga viti 2017 ka punuar si mësimdhënëse e gjuhës gjermane. Gjatë studimeve ka qëndruar në Universitetin e Freiburgut dhe atë të Vechtas si bursiste e ERASMUS+.
- 2. MA Valona Asllani (23.07.1997)** ka mbaruar studimet BA (9.23) dhe MA (9.73) në Departamentin e Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane të Fakultetit të Filologjisë (UP). Studimet MA i ka përfunduar me mbrojtjen e temës në fushën e gjuhësisë. Gjatë studimeve ka qëndruar në Universitetin e Freiburgut dhe atë të Kopenhagës si bursiste e ERASMUS+. Në vitin 2023 i ka regjistruar studimet PhD në drejtimin "Gjerministika si gjuhë e huaj" në UT Berlin. Kandidatja ka dëshmi për pjesëmarrje në një punëtori dhe një trajnim në fushën e metodologjisë së mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj organizuar nga shtëpia botuese HUEBER. Nga viti 2018 ka punuar si



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

mësimdhënëse e gjuhës gjermane në shkollë të gjuhëve të huaja, ndërsa në Universitetin „Ukshin Hoti“ është angazhuar në periudhën 2022-2024.

- 3. MA Brisilda Kaçiu** (15.09.1998) ka mbaruar studimet BA (8.06) dhe MA (9.36) në Departamentin e Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane të Fakultetit të Filologjisë (UP). Studimet MA i ka përfunduar me mbrojtjen e temës në fushën e gjuhësisë. Kandidatja nuk e ka dorëzuar dokumentacionin e plotë sipas thirrjes publike: nuk është dorëzuar kërkesa dhe dëshminë nga Gjykata.

Komisioni në përbërje: 1. Prof. Asoc. Dr. Bleritë Ismajli (kryetare), 2. Prof. Asoc. Dr. Sadije Rexhepi, 3. Prof. Asoc. Dr. Teuta Abrashi bazuar në angazhimin e saj gjatë studimeve në UP dhe në universitetet gjermane propozon që **MA Dalina Berisha** të angazhohet në cilësinë e bashkëpunëtores së jashtme për ushtrime për lëndët: Fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane, Sintaksë e gjuhës gjermane, Gjuhësi teksti, Metodikë e gjuhës gjermane me observim, Morfologji e gjuhës gjermane, Shkrim akademik, Leksikologji dhe fjalëformim, Metodikë me praktikë shkollore. Kandidatja MA Valona Asllani refuzohet bazuar në paragrafin 6 të nenit 7 të Rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe në përkufizimin që bën ligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, neni 3, pika 1.6. MA Brisilda Kaçiu refuzohet për shkak se nuk e ka dorëzuar dokumentacionin e plotë sipas thirrjes publike me nr. prot. 2/426, dt. 25/07/2024, pika V. a) dhe i).